22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 23

Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24

Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25

Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytje brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit

kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

616-25-10698-1-1-1/C1906

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	8.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës për 37 muaj
Sigurimi	9.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Cilësia e furnizimeve	16.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të materilait i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të përcaktuara në specifikimin teknik
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës.
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda 5 ditëve minimum pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	22.1	<i>Garancion 3 vite</i>

Shërbimet pas shitjes	23.1	<i>n/a</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtesise</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<i>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale - Prishtinë</i>

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-25-10698-1-1-1

Titulli i kontratës: 168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender

3. Çmimi total i tenderit është:

10,273.14 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

TABELA A						
Lista e pajisjeve për Hardware						
No	Modeli / Marka / Shitësi	Parametër / Karakteristika	Shtet	Shtet	Numri i Serisë	QDA
	Specifikat hardware të Tabelës së Mençur:	✓ Tabela Interactive Madhësia e tabelës: 75" ✓ Lloji i ekranit: LED ✓ Jetëgjatësia: Mbi 50,000 orë punë ✓ Rezolucioni: 4K UHD, 3840x2160 ✓ Frame rate: ≥ 125 Hz ✓ Të vijë me dy lapsa. ✓ Të ketë mbajtëse magnetike në kornizë për vendosjen e lapsave. ✓ Teknologjia e prekjes: Infrared i avancuar ✓ Të ketë zërim: 2x Altosparlant të INTEGRUAR minimum 20W ✓ Të ketë butona në anën e përparme të tabelës për rritjen e vullmit, ngrirjen e imazhit, qasje në mëny për Stand By Mode dhe për ndalje komplet. ✓ Të ketë Refresh rate: 60 Hz ✓ Response time: ≤8ms ✓ Ndritshmëria: 400 cd/m2				
		✓ Metoda e të shkruarit: Ekran interaktiv duhet të ketë një sipërfaqe qelqi me fërkim të ulët dhe rezistente ndaj gërvishjeve, të projektuar për të ofruar një përvojë shkrimi të lëmuar, si në letër. Sipërfaqja duhet të mbështesë preken precize dhe futjen e bojës dixhitale me vonesë minimale, duke ofruar një ndjesi natyrale të ngjashme me shkrimin me shënues në tabelë të bardhë. Veshja duhet të minimizojë shkëlqimin, të zvogëlojë njollosjen e gjurmëve të gishtave dhe të sigurojë shkrim dhe shënime të rehatshme për një kohë të gjatë. ✓ Saktësia në shkrim dhe prekje: 1mm ✓ Të ketë mundësi të lidhjes me Windows, Mac OS, dhe Chrome OS ✓ Të ketë sistem operativ minimum Android Versioni 13.0 në Gjyhen Shqipe me mundësi përditësimi (Upgrade) përmes OTA. ✓ Të ketë CPU: Quad-Core ✓ RAM Memorie 8GB DDR4 ✓ SSD: 64 GB ✓ Të ketë sensor infrared për përshtatje të dritës së ambientit ✓ Të suportoj OPS të versionit OPS-PC (mundësia e Integrimit të PC - Internat) ✓ Të ketë 40 pika të prekjes në ekran për Windows, 32 pika të prekjes në ekran për Android, 20 pika të prekjes në ekran për Mac dhe pika të prekjes në ekran për 10 për Chrome OS ✓ Pajisja duhet të funksionoj në lagështi të ajrit nga 20% deri në 80% lagështi jo-kondensuese ✓ Pajisja të ketë mundësi të ruhet në temperatura nga: -10°C deri në 60°C dhe të funksionoj ndetur edhe në temperatura nga 0°C - 40°C ✓ 1 port për integrim të OPS PC accessory slot ✓ Port HDMI® 2.0 me HDCP 1.4 dhe HDCP 2.2 support, Përpara 1 port, Prapa 2 porte ✓ 1 Display Port 1.2 – 1 Prapa,				

Portet/Komunikimet hyrëse: Input	✓ 1 Port VGA Port
	✓ 1 Port Stereo 3.5 mm
	✓ 1 Port RS-232 (DB-9 connector)
	✓ 1 Port RJ45 Ethernet hyrje
	✓ 1 port USB Type-C 4K @ 60Hz Display Port alternate mode, touch, dhe digital audio; USB 3.2 Gen 1, DFP for peripherals 15 W power output - Përpara
	✓ 1 Port USB Type-C 4K @ 60Hz Display Port alternate mode, touch, digital audio, USB2.0 Hi-Speed USB
	✓ 1 Port USB 2.0 Type-A
	✓ Porte USB 3.2 gen 1 type-A, 2 Përpara, dhe 2 Prapa
	✓ Porte USB 2.0 Type-B, 1 Përpara dhe 1 Prapa
	✓ HDMI 2.0 me HDCP 1.4 dhe 2.2 support x 1
Portet Dalëse:	✓ 1 Port Lan Out
	✓ Audio S/PDIF
	✓ Stereo 3.5 mm
Portet e tjera:	✓ Wired RJ45 dalje 1000 baseT
	✓ Wi-Fi të gjeneratës së gjashtë që mbështetë sigurinë WEP, WPA, WPA2, WPA3 PSK, dhe 802.1X EAP authentication protocols Dual Mode 2.4Ghz dhe 5.0Ghz dhe Akses Point për lidhjen e pajisjeve tjera
	✓ Bluetooth: 5.0 dual mode
Të ketë të përfshira:	✓ Kabllon e rrymes
	✓ Kabllon per lidhje me PC/Laptop USB 2.0 A to B - minimum 5 metra
	✓ 2 Lapsa
	✓ Antenat për Wi-Fi & Bluetooth
Konsumimi i energjisë	✓ Telekomandë bashkë me AAA Bateri
	✓ Instruksonet nga prodhuesi per instalimin e tabelës
	✓ Paisja duhet të ketë shpenzime minimale në energjisë, të mos kaloj 88W gjatë punës dhe më pak se 0.5W kur është në Stand-By
Çertifikimet	✓ Çertifikuar si Energy Star, dhe HDCP
	✓ CE, LVD, CB, EMC, RED, REACH, RoHS, Battery, POP Ecodesign
	✓ Të ketë built in split screen që mundëson të ndërveproni në një anë të tabelës dhe në tjetrën të përdoret ndonjë aplikacion tjetër - e gjithë kjo në mënyrë simultane. P.sh. gjysma e tabelës është e bardhë dhe gjysma tjetër e tabelës shfaq një proces tjetër (mund të jetë video) për të cilin ju merrni shënime direkt në tabelë. Apo, thjesht të ofroj mundësinë e përdorimit të dy aplikacioneve në të njëjtën kohë!
	✓ Të ketë Auto Draw Pen të integruar në tabelën e bardhë (Whiteboard) ku çfarëdo që vizatohet apo tentohet të ilustrohet, tabela automatikisht sygjeron opsione të formës së rregullt të asaj që po tentoni ta ilustroni. P.sh. nëse ju dëshironi të vizatoni ndonjë objekt, p.sh. ndonjë kafshë apo objekt tjetër, ju filloni ta vizatoni atë dhe në ndërkohë, tabela i shfaq sugjerimet e formës së rregullt të atij objekti.

Specifikat softuerike të
Integruara direkt në tabelë

✓ Të ketë mundësinë e inçizimit të ekranit (Screen Record), Screenshot të komplet ekranit ose vetëm të një pjese të caktuar te ekranit dhe të dërgohet direkt në tabelën e bardhë (Whiteboard)
✓ Të ketë mundësinë e Inkuadrimit/shfaqjes të materialeve nga burimet e ndryshme hyrëse (input ports, Hdmi, VGA, DP) direkt një pjesë/kënd të tabelës së bardhë ku edhe mund të ndërveprohet dhe shkruhet mbi to. Pra, mundësinë e inkuadrimit të burimeve tjera direkt/njëkohësisht në tabelën e bardhë.
✓ Të ketë veçorinë Spot Light që mundëson fokusin vetëm në një zonë të tabelës duke errësuar pjesën e mbetur të tabelës
✓ Të ketë mundësinë e shtimit të kronometrit ose matësin e kohës me alarm (zile)
✓ Të ketë veçorinë Overlay – që mundëson shkrimin mbi çdo aplikacion dhe ofron mundësinë nëse overlay të ruhet si foto në tabelë së bashku me mbishkrimin.
✓ Të ofroj mundësinë e Screen Lock me kod për të menaxhuar aksesin në table nga mësimdhënësi
✓ Të ofroj mundësinë e kalkulatorit shkencor si vegël
✓ Tabela duhet të ofroj mundësinë që shënimet të cilat janë bërë në WhiteBoard të ruhen në memorien e tabelës SSD, Cloud apo të eksportohen si .pdf, foto, apo të dërgohen direkt në një email apo edhe të shpërndahen si një QR kod. Të njejtat shënime duhet të kenë mundësinë edhe të importohen, hapen ose editohen edhe nga ndonjë tabelë tjetër
✓ Të ketë të integruar Screen Share ku mund të lidhen të paktën 9 pajisje dhe secili të shfaq ekranin e tyre në tabelën interaktive në të njëjtën kohë
✓ Të ketë mini-aplikacione (widgets) interaktive të qasshme direkt nga tabela (anësore)
✓ Të ketë mundësinë e shtimit të ndonjë fotografie në background të White Board.
✓ Tabela Interaktive, duhet automatikisht të njeh / përkrah metodën e futjes së të dhënave nga forma të ndryshme (LAPS, Gisht, Pëllëmbë të dorës apo Gomë të jashtme fizike, dhe të rregulloj funksionalitetin përkates, (Shkrim, lëvizje apo fshirje). Pa pasur nevoj ndrrimin manual të mjetëve për funksionalitete të ndrysh,e.
✓ Të ketë mundësinë për shtimin e aplikacioneve shtesë
✓ Të ketë mundësinë e integritetit të kamerës së jashtme
✓ Të ketë mundësinë e instalimit të paketës WPS Office

Programet softuerike për Edukim – Desktop, Cloud dhe Web - (OLE - Janë të lejuar që të përdorin dhe Aplikacione THIRD PARTY APPLICATION që të arrijnë funksionalitetin e kërkuar) - në mënyrë që të jetë kompatibil / funksional me Tabelat Interaktive	✓ Të ketë mundësinë konvertimit të shkrimit me laps në tekst fontesh, p.sh. nga shkrimi me laps në font Calibri.
	✓ Të ketë Cloud storage Access
	✓ Soufteri i Tabeles Interaktive, duhet të ketë mundësin që të instalohet edhe në PC, NB.
	✓ Soufteri i Tabeles Interaktive, që do të instalohet në PC, NB Version (Windows apo MAC - duhet të jetë në gjuhën shqipe).
	✓ Të ofroj mundësinë e instalimit të softuerit në verzionin Desktop në komputerin e klasës apo paisjen e mësimdhënësit. Të njejtat dokumente të krijuara në verzionin Desktop duhet të hapen edhe në verzionin Android direkt nga tabela (pa PC) apo në verzionin Web dhe të ruhen në cloud platformën e prodhuesit apo platforma - Third-Party (të palës së tretë).
	✓ Të i ofroj mësimdhënësve të krijojnë mësimet - prezantimet, ligjerimet nga orët e mbajtura, të ruajnë materialet e tyre në verzionin desktop të softuerit dhe të prezantojnë ato para klasës apo edhe online, qoftë në verzionin desktop apo Web platformë.
	✓ Të ketë mundësinë e konvertimit të shkrimit me laps në tekst fontesh, p.sh. nga shkrimi me laps në font Tekst.
	✓ Të ketë mundësinë e shpërndarjes (exportit) të materialeve mësimore, Prezantimeve, mësimëve, ligjeratave, teksteve nxënësit në formatin html, ppt, pptx, pdf, png, jpeg, gif, bmp, iwb, etj
	✓ Të ketë mundësinë e marrjes (IMPORT) të materialeve mësimore nga nxënësit apo kolegët në mes veti (p.sh. Detyrat e shtëpisë, Prezantime, mësimëve, etj) në formatin html, ppt, pptx, pdf, png, jpeg, gif, bmp, iwb, etj
	✓ Të ketë mundësi printimin e mësimit të shpjeguar
	✓ Të ketë mundësinë e inçizimit të mësimit, hapave të shpjegimit shkruar/prezantuar në tabelë dhe po ashtu edhe zërin e mësimdhënësit. Kjo është e nevojshme pasi që mësimi mund të dërgohet apo ngarkohet në internet dhe mësimi mund të ndjeket edhe më vonë nëse nxënësi nuk ka mundur të ndjek mësimin live.
	✓ Të ketë objekte 3D të gatshme dhe të lëvizshme, për, si: Matematikë, Gjeografi, Biologji, Astronomi dhe lëndë tjera të nivellit global!
	✓ Resurse të gatshme mësimore në librarinë lokale të cilat edhe mund të popullohen nga ato ekzistuese nga mësimdhënësi.

		✓ Shembuj ekzistues të formateve të aktiviteteve mësimore të cilat mund të përdoren si të gatshme, modifikohen apo edhe të shtohen nga mësimdhënësit. Mësimdhënësi mund të përdor ato vazhdimisht për klasat tjera apo gjeneratat e tjera. Kjo i mundëson mësimdhënësit që ti ruaj dhe të krijoj një librari aktivitetesh gjatë karrierës së tij/saj mësimore.				
1.00	Shkrimi mbi aplikacione të tjera	✓ Kur një kompjuter lidhet me Tabelen Interaktive, është e dëshirueshme (Opsionale) që softueri ti ofroj mësimdhënësit të shkruaj, shënoj ose vizatoj mbi dokumentet e hapura si: shfletues të internetit (Internet Browser), PDF, video, foto, PowerPoint, Word, Excel... dhe të ruhen ndryshimet dhe shkrimet në dokument	copë	1.00	3,125.00 €	3,125.00 €
		✓ Të mundësoj ruajtjen e shkrimeve/vizatimeve mbi Explorer (Windows Explorer) apo dokumente si PDF, Video, Foto, Power Point, Excel, Word. Pra, shkrimi mbetet i integruar në atë faqe/dokument, jo vetëm si Screen Shot. Ofertuesit, mundë edhe të ofrojnë software THIRD PARTY - apo të palës së tretë apo të krijuar vetë që ofronë këtë mundësi.				
		✓ Në internet browsers, të mundësoj ruajtjen e anotimeve në të gjitha "Tabs" të hapur dhe ti shfaq ato ndaras për secilin tab.				
		✓ Të ketë mundësinë e njohjes së ekuacioneve algjebrike apo trigonometrike gjatë shkrimit me laps, ti konvertoj ato në fonte të rregullta, pastaj të shfaq ekuacionin në formë të grafikoneve në drejtëza ose lakore në kuadrante				
		✓ Të mundësoj shfaqjen e ekuacionit të saktë pas manipulimit të lakores në menyrrë "manuale" nga mësimdhënësi. Pra, kur lakorja ndryshon, atëherë ndryshon edhe ekuacioni.				
		✓ Ti mundësoj mësimdhënësit mbarvajtjen e spjegimit të orës mësimore në klasë, Online përmes llogarisë në CLOUD - të ofruar nga Prodhuësi, përfaqësuesi i Prodhuësit, përmes platëformës apo nga një platëformë e palës së tretë.				
		✓ Në këtë llogari mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje ti krijoj, ruaj materialet e veta mësimore direkt në platformë ose lokalisht në kompjuter.				
		✓ Ti mundësoj mësimdhënësit përgaditjen e detyrave të shtëpisë, ti ngarkoj në cloud llogarinë personale të mësimdhënësit				
		✓ Në rastet kur mësimi zhvillohet me aktivitete interaktive, softueri duhet të gjeneroj një ID Unike për klasën mësimore. Mësimdhënësi ju dërgon nxënësve që nuk janë në klase atë ID ose QR kod (ndërsa nxënësit prezent shofin atë ID-në/QR kodin direkt në tabelë).				

OE - Duhet të jetë i Autorizuar nga Prodhuësi apo Distributori o prodhuësi i autorizuar për tasteronin e Kosovës. Kërkohet MAF ose DAF - Në rast se kërkohet DAF - duhet dëshmi për Distributorin se është i Autorizuar nga prodhuesi për Tasterin të Kosovës. OE Duhet të ketë staf të trajnuar, për Monitorim, Instalimë, Konfigurim dhe për trajnim të Arsimtarëve dhe stafit të shkolave dhe Komandës. OE - duhet të dëshmojë me certifikatë se ka staf të trajnuar

Aplikacionin në Cloud dhe Web

✓ Qasja në orë të mësimit apo në ligjeratë - për nxënësit që nuk janë prezent në klasë, duhet të jetë e mundur përmes cfarë do pajisje apo sistemi operativë, që nxënësit posedojnë (Windows, MAX, IOS, ANDROID, Linux etj.)
✓ Të ketë një librarë me materiale të gatshme duke u bazuara nga praktikatat ndërkombëtare, dhe që mund të përzgjedhen nga Mësuat e lëndës përkatëse, për zgjerim apo përmisim të lëndës përkatëse.
✓ Të ofroj modele të gatshme të aktiviteteve ku nxënësit të shprehin mendimet, idetë e tyre rreth mësimit, shkollës apo rreth një teme të caktuar
✓ Të ofroj vegla mësimore interaktive në menyrë që mësimdhënësi shtron pyetje (përgatit teste aty për aty) për mësimin e shpjeguar në formatin A. B. C. D. direkt nga Tabela Interaktive
✓ Nxënësit mund të përgjegjen me A.B.C.D.
✓ Përgjegjet e nxënësve, mund të i shoh vetëm mësimdhënësi
✓ Nxënësit mund të përgjegjen përmes pajisjeve të mencuara që i posedojnë (në shtëpi apo klasë), qoftë (windows, IOS, Android, Linux etj).
✓ Mësimdhënësit, mund të i shohin rezultatet të cilat mund të shfaqen edhe në formë të përqindjes (sa janë të skata sa janë të pasakta).
✓ Mësimdhënësit, gjithashtu shohin rezultatet për secilin nxënës veq e veq.
✓ Aplikacioni duhet të ketë mundësinë e eksportit të rezultateve në excel - për të mbajturë evidencë.
✓ Kjo platformë duhet të mundësoj storage për përdorim minimum 50MB në webaplication falas për çdo mësimdhënë, me ID - Unikë të veten. Gjithashtu, mundësinë e UPGRADE në Unlimited Storage (Hapsirë të pa-kufizuar për ruajtjen e shënimeve, prezantimeve, ligjeratave të tyre).
✓ Të ofroj modele të gatshme të simulimeve interaktive për lëndët shkencore në formë argëtuese që angazhojnë studentët të mësojnë përmes eksplorimit dhe zbulimit duke ndryshuar numrat (si inpute), lëvizjen e objekteve... dhe në të njëjtën kohë të ndryshohet simulacioni. Simulimet të jenë për lëndë të ndryshme si p.sh.: Fizikë, Matematikë, Kimi, Astronomi...
✓ Të ketë veçori kompetitive në mes të nxënësve si p.sh. kur dy nxënës dalin në tabelë për të kryer një aktivitet, a/ajo që kryen detyrën/aktivitetin i pari shtyp butonin me zhurmë "Buzzer"

	✓ Ti mundësoj mësimdhënësit përzgjedhjen e nxënësve random nga lista e nxënësve (të klasës) për tu përgjigjur në pyetjet "Pop up" të mësimdhënësit apo daljen në tabelë të nxënësit
	✓ Të ofroj kalkulator të grafeve për zgjidhjen e problemeve matematikore dhe demonstrimin e grafeve sipas ekuacionit matematikor të dhënë nga përdoruesi aty për aty, sikurse edhe të kenë mundësi të punojnë së bashku Mësimdhënësit dhe nxënësit dhe të i ruajnë mësimet e realizuar, në mënyrë që të kenë qasje më vonë.
	✓ Të ofroj librari me modele aktiviteteve interaktive në formë të lojërave që mundësojnë aktivizimin e gjithë klasës për të përfunduar aktivitetin/lojen; Në të njëjtën kohë duke mësuar
	✓ Të ofroj modele të gatshme të kuizeve dhe teste vlerësuese të cilat mund të ofrohen te nxënësit individualisht ose edhe ne grupe, kurse mësimdhënësi të ketë mundësinë në kohë reale të veshgojë përgjigjet e studentëve dhe të eksportoj në fund vlerësimet në formatin e Excel-it
	✓ Të ketë mundësinë e adaptimit dhe konvertimit të formulave të lëndëve shkencore nga lapsi në ekuacione apo formula matematikore
XCHANGE (Web Server)	✓ Mësimdhënësit, duhet të kenë qasje në platforma ndërkombëtare me mësimet të gatshme të kategorizuara sipas nivelit dhe ciklit të arsimit apo lëndës që ata ligjerojnë, të tipit: (p.sh. Thysat apo shumëzim, të kenë shembuj dhe forma të ligjerimit praktike që mund të i shfrytëzojnë në mësimet - ligjerimet e tyre).
	✓ Të ofroj mësimdhënësit mësimet e veta të ngarkojnë në këtë platformë për të bërë të qasshme nga mësimdhënësit të tjerë. (Edhe mësimdhënësi duhet ta kategorizoj atë mësim para ngarkesës në këtë web server)
	✓ Të gjitha mësimet të shfrytëzueshme që jepen - FREE (Pa - Pages), nga Prodhuesi i të njëjtit BRAND sikurse Tabelat Interaktive, në cilat mësimdhënësit kanë qasje dhe mund të i shfrytëzojnë për të përgatitur ligjeratat e tyre, mund të adaptohen dhe të përshtaten sipas korrikulave të arsimit të përcaktuara nga MASHT në Kosovë.
	✓ Ti ofroj mësimdhënësit shkëmbimin e prezantimeve dhe aktiviteteve mësimore mes vete. P.sh.: një arsimtar i Fizikës ta përgaditë mësimin e klasës 6 lidhur me gravitetin dhe një Arsimtar tjetër i të njëjtës lëndë ta përgaditë mësimin për Energjinë kinetike dhe të kenë mundësinë e shkëmbimit të mësimave mes njëri-tjetrit.

Programi Softuerik për Administrimin e Tabelave – Remote Management (OE - Janë të lejuar që të përdorin dhe Aplikacione THIRD PARTY APPLICATION që të arrijnë funksionalitetin e kërkuar) - në mënyrë që të jetë kompatibil / funksional me Tabelat Interaktive	✓ Tabelat e mencura, të ofruar nga OE, duhet të kenë mundësinë të monitorohen nga distanca - përmes aplikacionit - CLOUD, nga i krijuar për menaxhim të Tabelave Interaktive. Për Administratorë - Lokal apo Nacional.
	✓ Monitorimi - vendodhja, menaxhimi dhe rregullimi i problemeve eventuale Online.
	✓ Mundësia e dërgimit të mesazheve me rendësi, nga administratori përmes aplikacionit për të gjithë përdoruesit e Tabelave të mencura. P.sh. Njoftimë me rendësi, njoftimë rreziku, etj etj.
	✓ Grupimi & Etiketimi, për modelin e Tabelës së mencurë - Për menaxhim efikas të inventarit - Tabelave të mencura si ASET I shkollës.
	✓ Mundësia për me ju qasë nga Distanca, për me interveni, rregullu ndonjë problem eventuale të softuerit (Remote Troubleshooting).
	✓ Mundësia për me i largu Tabelat e Mencura nga Soufiteri.
	✓ Mundësia për me i instalu, menaxhu, me i përditësu (upgrade) - Softuerin dhe Soufiterët përbërës të Tabelave të mencura nga Distanca.
	✓ Mundësia për me i vendos rregullat dhe politikat e përdorimit të Tabelave të mencura.
	✓ Menaxhimi i Setting - së të Tabelave të Mencura - Remotly.
	✓ Dërgimi i komandave ekektuese të Tabelave të Mencura - Remotly.
	✓ Dërgimi i Dokumenteve (filave të ndryshëm) - Remotly. P.SH.(Rregullore e re për nxënësit, se si duhet të sillen në shkollë), apo si p.sh. (Celularët janë të ndaluar për përdorim në klasë - Rregullë nga Drejtoria e Arsimit)
	✓ Bllokimi dhe Zhblllokimi i Tabelave të Mencura - Remotly.
	✓ Restartimi, Fikja dhe zgjimi i Tabelave të mencura - Remotly.
	✓ Kthimi i Tablesës së mencurë në Konfigurim sikurse nga Prodhues (Factory Reset) - Remotly.
	✓ Operatori Ekonomik - Duhet të ketë stafë të certifikuar nga Prodhuesi apo Distributori i Autorizuar i Prodhuesit për Shitje, Servisë dhe Trajnimë (për rajoninë e Kosovës), për montimë dhe konfigurimë të Tabelave të Mencura. Kërkohet Certifikata e punonjësit që ka përfundu Instalime për montimë, konfigurimë dhe Servis Support.

	Kërkesat Administrative	✓ Operatori Ekonomik - Duhet të ketë stafë të certifikuar nga Prodhuesi apo Distributori i Autorizuar i Prodhuesit për Shitje, Servisë dhe Trajnimë (për rajonin e Kosovës), për Trajnimë të mësimdhënësve për përdorimë të Tabelave të mencura. Duhet të dëshmohet me Certifikatë. ✓ Operatori Ekonomik - Duhet të ofrojë një Deklaratë - Autoritetit Kontraktues, nga Prodhuesi apo distributori i prodhuesit për Rajonin e Kosovës: Softueri i ofruar për përdorim nga mësimdhënësit - në qoftë se nuk është në gjuhën shqipe do të përkthehet në gjuhën Shqipe në mënyrë që të i lehtësohet përdorimi për mësimdhënësit. Kërkohej deklaratë nga Prodhuesi apo Distributori dhe Operatori Ekonomik - Ofertues. ✓ Autorizimë nga Prodhuesi apo Distributori i Autorizuar i Prodhuesit për rajonin e Kosovës (Duhet të dëshmohet) - Kërkohej MAF ose DAF. ✓ Softueri për mësimdhënie në Tabelë të Mencur dhe që njëkohësisht do të instalohet në PC apo Laptop të mësimdhënësve - duhet të silllet në USB apo CD, në zyrë e Prokurimit - Para Datës për Ofertë Financiare. ✓ Për modelin e ofruar, sipas specifikave teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues si më lartë, duhet të dëshmohen me katalog apo Datasheet, për pjesën e Harduerit (Tabeles së Mencurë) dhe Softuerit (SW - Për mësimdhënie).					
2.00	Mbajtëse Statike	✓ Mbajtëse për Tabelen Digjitale - Statike	NA	copë	1.00	75.00 €	75.00 €
3.00	Montimi	✓ Montimi i Tabelave të Mencura, në të gjitha shkollat / Klasët, sipas listës së Drejtorisë së Arsimit.	NA	copë	1.00	85.00 €	85.00 €
4.00	Konfigurimi	✓ Konfigurimi, Lidhja në rrjetë, konfigurimi në Cloud, Instalimi i Softuerit - përkatës në Tabelen Interaktive dhe në PC apo Laptop	NA	copë	1.00	115.00 €	115.00 €
5.00	Trajnimi	✓ Trajnimi i Stafit - për përdorimë dhe për ligjerimë. (Për përdorimë të Tabeles së Mencurë dhe për përdorimë të Softuerit).	NA	orë	1.00	100.00 €	100.00 €
6.00	Softueri për Ligjerim	✓ Kosto e Softuerit - për ligjerimë, për përdorimë të materialeve të gatësme, që mund të shfrytëzohen nga mësimdhënësit. Nëse është e aplikushme.	NA	copë	1.00	185.00 €	185.00 €
7.00	Softueri për Menaxhim	✓ Kosto e Softuerit - për menaxhim, konfigurim dhe Service Support (Remotly). Nëse është e aplikushme.	NA	copë	1.00	75.00 €	75.00 €
Tabela A - Grand Total: (Pozicioni 1 - 7)							3,760.00 €
TABELA B							
No	Modeli - Lloji i pajisjes	Përshkrimi i kërkesës	Sqarim	Sasia	Çmimi në TRY	Total	
Specifikat për rrjetë - Aktivë:							
		Firewall Router - i Dedikuar për një shkollë, për menaxhimin e riskut nga sulmet kibernetike në rrjetë. Duhet të jetë Enterprise - Grade. Të ketë mundësi të grumbullimit dhe të analizimit të të dhënave, dhe mundësi të qasjes nga distanca me VPN. Gjithashtu duhet të ketë mundësi për menaxhimin e lehtë dhe të jetë fleksibil për të u administruar ose lokalisht ose përmes SMS.					

